




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.05.2021

Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 347, të datës 26.03.2021, në mbledhjen e mbajtur të datës 07.04.2021 dhe në vazhdimin e mbledhjes tjetër të radhës së Kuvendit të Komunës, të mbajtur më datë 29.04.2020 aprovon: Raportin financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2020, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar edhe në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:


V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,855,838.58€.
 2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 5,196,657.89€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,651,112.96€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,978,551.43€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 29,516.30€.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.
- Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 05.05.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 287, të datës 26.04.2021, paraqitur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:


V E N D I M


Për rrënimin e objekteve të vjetra publike në fshatrat e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Aprovohet propozimi për rrënimin e objekteve të vjetra dhe të dëmtuara në fshatrat Komunës së Fushë-Kosovës si vijon:
 - 1.1 Të rrënohet objekti i vjetër i Ambulancës së Mjekësisë Familjare, në fshatin Sllatinë e Madhe, me qëllim të ndërtimit të objektit të ri publik shëndetësor për plotësimin e nevojave dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore kualitative për banorët e fshatrave përreth si: Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Harilaç dhe Henc;
 - 1.2 Të rrënohet objekti i vjetër i Ambulancës së Mjekësisë Familjare, në fshatin Bardh i Madhë, pasi që objekti i ri shëndetësorë është në ndërtim e sipër;
 - 1.3 Të rrënohet objekti i vjetër i shkollës, në fshatin Pomozotin, për krijimin e hapësirës për nxënës dhe rininë e fshatit;
 - 1.4 Të rrënohet objekti i vjetër i Shtëpisë së Kulturës, në fshatin Miradi e Epërme, pasi që paraqet rrezik nga vjetërsia e tij dhe demolimi. Qëllimi i rrënitit është rritja e hapësirave për aktivitete për fëmijët dhe rininë e fshatit.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për rrënimin e objekteve të përshkruara në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit, Drejtorisë së Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit, Drejtorisë së
Financave e Buxhetit, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies
Sociale, Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe
Sport dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 05.05.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 246, të datës 20.04.2021, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.5, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.1, shkronja (a), të Ligjit për tokën bujqësore Nr. 02/L-26 (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2007), nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të Ligjit për rregullimin e tokës Nr. 04/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 03/2012), nenin 6, paragrafi 6.3, nenin 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 61, paragrafi 5, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 246, të datës 20.04.2021, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Eu - Beton'

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 246, të datës 20.04.2021, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në ngastrën kadastrale Nr. P-725140003-00779-7, me sipërfaqe $S=9,900m^2$, arë e klasës së pestë, pronë private në vendin e quajtur 'Shume Krivovo' në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afarist Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar 'Eu - Beton', me numër identifikues të biznesit 811327205, pronar Përparim Thaçi.
2. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për zhvillimin e biznesit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 'Eu-Beton', në Zonën Industriale ZI I - Blloku 1215.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së BZHR, Palës dhe Arkivës.


Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.05.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 29.04.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 447, të datës 26.04.2021, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në lidhje me kërkesën Nr. 06-580/02-0009476/21, të datës 04.03.2021 nga pala Jeton Kelmendi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare për shërim

1. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për shërim shëndetësorë dhe rehabilitim, për palën Jeton Kelmendi nga fshati Sllatinë e Vogël, për vendosjen e protezës së këmbës së majtë prej gjurit sipas diagnozës: Amputatio cruris sin pp vulnus explosivum.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

[Signature]